



Data/Permit/Me Dated <b>26.12.2024</b>			
Nr. Prokurimit	Nr. mbr.	Vatikan	Vlera
<b>02-370/03-1482</b>			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republik of Kosovo**  
**Komuna e Vitisë**  
**Opstina Vitina-Municipality of Vitina**



**ZYRA E PROKURIMIT**

**KONTRATË PËR FURNIZIM**

<b>Nr.prokurimit</b>	<b>VI657</b>	<b>24</b>	<b>11027</b>	<b>1-2-1</b>
<b>Nr. brendshëm</b>	<b>VI657</b>	<b>24</b>	<b>0 52</b>	<b>121</b>

**TITULLI I KONTRATËS : Furnizim me material për stomatologji**

**E LIDHUR NË MES TË**

Operatori ekonomik	Autoriteti kontraktues
<b>Grup i Operatorëve Ekonomik Alfa Dent SH.P.K.; GENIUS KOSOVA SH.P.K., Rr.Ali Tepelena pn., 70000, Ferizaj, Kosovë Perfaqësuar nga:</b>	<b>KOMUNA E VITISE</b>  <b>Perfaqësuar nga:</b>
<b>Labinot Llabjani</b>  	<b>Fadil ABAZI, menaxher i prokurimit</b>   

V.V

V.V

## **PJESA B: KONTRATA**

**KOMUNA E VITISË**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë, dhe  
**Grup i Operatorëve Ekonomik Alfa Dent SH.P.K.; GENIUS KOSOVA SH.P.K., Rr.Ali Tepelena pn., 70000,  
Ferizaj, Kosovë** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate  
publike për:

**Furnizim me material për stomatologji** me numër Identifikues **VI657-24-11027-1-2-1**

### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me material për stomatologji**

1.2 Kontrata hynë në fuqi diten e nenshkrimit.. Kontrata fillon së implementuari nga dita nënshtrohet **20.12.2024** dhe përfundon me **19.12.2024**, që nënkuption se kontrata është njëvjeqare.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **5** ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vend i Komuna e Vitisë, do të jetë **te gjitha njesite shpenzuese**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **7,900.57 €;**

Me fjalë: **Shtatëmijë e nëntqind euro e 57 cent**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shënoj]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale te pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

[Kontrata perbehet me **shume** dërgesa]


[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilén shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

E hartuar në gjuhen **Shqip**<sup>2</sup> në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

#### Për Ofruesin e furnizimeve

#### Për Autoritetin Kontraktues

<b>Emri:</b>	<b>Labinot Llabijani</b>	<b>Emri:</b>	<b>Fadil ABAZI</b>
<b>Pozita:</b>		<b>Pozita:</b>	<b>Menaxher i Prokurimit</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>		<b>Data:</b>	
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **[furnizimeve]**

#### Neni 8 Vonesat në ekzekutim

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose te gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] ] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### Neni 9        Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10        Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11        Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon ton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12        Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 30 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13        Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata themelore Gjilan-dega ne Viti* në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshtkimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b>
	2.4	Liferimi i mallrave të kryhet brenda 48 orë më së largu nga porosia ose leshimi Urdherblerjes
Cilësia e furnizimeve	18.2	<b>Specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.</b>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<b>Menaxher i kontratës Shpend Ismajli</b>
Pagesa	20.1	<b>Pagesat për furnizimin e kryer do të bëhen sipas faturave te furnizimit dhe urdhër blerjeve</b>
Dorëzimi	21.3	Sipas keresave te njesive shpenzuese, ne lokacionet ku ato gjinden..
<b>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes</b>	31.2	Palet do te bejne te gjitha perpjekjet për te zgjdhur ne menyre miqsore te gjitha mosmarveshjet qe mund te ndodhin ne mes tyre apo te shfaqet ndonje mosmarveshje , palet do te lajmrojne njera-tjetren me shkrim per poziten e tyre ne mosmarveshje dhe per ndonje zgjdhje qe ata konsiderojne se eshte e mundhme
<b>Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore</b>	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike</b> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]. <b>Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje ekonomike</b>



REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Praimit/Pranjeni Me Dina	20.12.2024		
No. I. Tregjimi Qep. Dha	Humer Përo	Sifra e Dokumentit	Vlera Vjetore
02-370101-1501			



## REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA VITISË

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave për Prokurimin Publik / Nr.001/2022, në bashkëpunim me dhe propozim të Përgjegjësitë të Njësisë Kërkuese dhe Drejtoret të Drejtorisë për Prokurim Publik, merr:

**V E N D I M**  
Për

### I. Emërimin e Menaxherit të Kontratës

#### I. Shpend Ismajli caktohet Menaxher i Kontratës-Titulli: Furnizimi me materjal për stomatologji, Nr.Pro. 657-24-11027-1-2-1, numri i brendeshem VI657-24-052-121

- Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit Merrushe Ahmeti dhe *Menaxher i kontratës* dhe obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 70 të Rregullave për Prokurimin Publik Nr.001/2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës.

**Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Kontratës, janë që të :**

- Në pajtim me nenin 70.10 të Rregullave për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";
- Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specikuara në Kontratë;
- Sigurojë që Operatori Ekonomik përbushë të gjitha obligimet e performances apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Operatori Ekonomik dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Komuna i përbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;

- h) Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- i) Bëj vlerësimin e performances se operatorit ekonomik në sistem të prokurimit elektronik pas përfundimit te kontratës
- j) Nxjerrë variaçione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe legjislacionin për natyrën e aktivitetit ;
- k) Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kerkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- l) Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;
- m) Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- n) Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ.

Kopje: Menaxheri i Kontratës;  
 Drejtorisë së Prokurimit;  
 Drejtorit të Njësisë Kërkuese





Komuna e Vitise  
Municipality of Vitia  
Opstina Vitina





QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILARE NË VITI  
Main Health Family Center of Vitia  
Glavni Centar Porodicni medicine

**Paramasa e furnizimit me material Stomatolgjik për vitin 2024**

Nr	Përshkrimi	Nj. matëse	Sasia	Çmimi për njësi (tvsh)	Shuma
1	Lidokainë amp 2% me adrenalinë 2x100	copë	4999	0.25	€ 1,249.75
2	Nervheqës	copë	80	0.20	€ 16.00
3	Helio A1	copë	30	8.00	€ 240.00
4	Helio A2	copë	50	8.00	€ 400.00
5	Primer bond	copë	30	8.00	€ 240.00
6	Brusha për bond	copë	40	1.00	€ 40.00
7	Freza të diamantit me demenzione të ndryshme	copë	800	0.50	€ 400.00
8	Freza të qelikut për kunderkand	copë	400	0.50	€ 200.00
9	Fosfat cement për shtresë	copë	50	7.00	€ 350.00
10	Letër celuloide	copë	20	2.00	€ 40.00
11	Shkopinjë gutaperka 20	copë	55	0.02	€ 1.10
12	Shkopinjë gutaperka 25	copë	50	0.02	€ 1.00
13	Shkopinjë gutaperka 30	copë	45	0.02	€ 0.90
14	Shkopinjë gutaperka 35	copë	45	0.02	€ 0.90
15	Shkopinjë gutaperka 40	copë	50	0.02	€ 1.00
16	Shkopinjë gutaperka 15-40	copë	45	5.00	€ 225.00
17	Paper point 15-40	copë	70	5.00	€ 350.00
18	Lidokainë spray 10% Flakon	copë	30	7.00	€ 210.00
19	Brusha për pastrimin e instrumenteve	copë	100	1.50	€ 150.00
20	Acid	copë	35	2.50	€ 87.50
21	Dezinfektues për instrumente 700ml	copë	34	1.00	€ 34.00
22	Chlumsky	copë	19	4.50	€ 85.50
23	Vaj turbine	copë	15	13.00	€ 195.00
24	Asepsol 5%	liter	30	4.50	€ 135.00
25	Zgjerues kanait 15-40	copë	50	5.00	€ 250.00
26	Zgjerues 20	copë	40	0.02	€ 0.80
27	Zgjerues 25	copë	40	0.02	€ 0.80
28	Zgjerues 30	copë	40	0.02	€ 0.80
29	Zgjerues 35	copë	41	0.02	€ 0.82
30	Zgjerues 40	copë	40	0.02	€ 0.80

31	Zgjerues të kanalit Titanium	copë	40	4.00	€ 160.00
32	Pastë për devitalizim (pa arsenik)	copë	40	7.00	€ 280.00
33	Jodoform pluhurë	copë	40	7.99	€ 319.60
34	Mbushje devinitive të kanaleve	copë	40	14.99	€ 599.60
35	Hemostatik për ndaljen e gjakderdhjes	copë	44	0.30	€ 13.20
36	Mbushje të përkohshme të kavitetit	copë	35	3.50	€ 122.50
37	Zinc Oxyde L+P	copë	45	1.00	€ 45.00
38	Goma për polirimin e mbushjeve	copë	150	0.40	€ 60.00
39	Calcium Hydroxid me Jodoform	copë	50	8.90	€ 445.00
40	Calcium Hydroxid pa Jodoform	copë	45	4.50	€ 202.50
41	Calcium Hydroxid 2 komponentë	copë	45	1.10	€ 49.50
42	Alveogyl	copë	40	6.50	€ 260.00
43	Trakë abraziv	copë	40	0.15	€ 6.00
44	Glasjonomer	copë	38	5.00	€ 190.00
45	Jodoform pluhurë eugenal	copë	22	1.00	€ 22.00
46	Zing fosfat cement	copë	7	7.00	€ 49.00
47	Gilpana Mandibullare 25G	copë	1000	0.02	€ 20.00
48	Zgjerues per endo motor	copë	20	2.00	€ 40.00
49	Pastë mumifikuese per amputim	copë	5	20.00	€ 100.00
50	Freza per kavitron	copë	5	2.00	€ 10.00
Totali					€ 7,900.57

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Alfa Dent Sh.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	Labinot Llabjani
NËNSHKRIMI:	
DATA:	15.11.2024
VULA:	

1.   
 2.   
 3. VDely

## Deklaratë e Garantuesit

### SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 135020

#### Për KUVENDI KOMUNAL VITI

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

#### Në emër të Alfa Dent SH.P.K.

( emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operaratori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Furnizim me material për stomatologji**

Nr. prokurimit: 657-24-11027-1-2-1

#### Garacion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t' i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **791.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputha e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **791.00€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 396 ditë kalendarike prej **20.12.2024** deri më **20.01.2026**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garpcionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejtë për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përbushjen e tërësishtme të detyrimeve.

Data lëshimit: 20.12.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

